



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Primer - Prilog: Kërkimi 10-04-2024 vit.god

Kr. i organit Çrë. Brëj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendosje
06-	070/01-		634



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipal Vitina

Bazuar në dispozitat ligjore neni 2 lidhur me nenin 5,6,7, të Udhëzimit administrative MTI Nr.03/2014 për Procedurën, Formën dhe Përmbajtjen e Konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapsirave të zonave ekonomike në harmoni me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë (me numer protokollit të dates )Komuna e Vitisë në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore shpall:

### **Konkurs për Vendosje të Bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë- Viti-Faza e parë**

Parku i industrial në Budrik të Vitisë shtrihet në kilometrin (duhet të ceket kilometri) pergjatë magjstralës në fshatin Budrik Komuna e Vitisë

**Zona Kadastrale Budrikë e EpermeViti, Ngastra kadastrale:**

**P-70101012-00641-1 me sipërfaqe prej 155000m<sup>2</sup>, bujqësore në vendin e quajtur "Batânica"**

**Totali 155000 m<sup>2</sup>**

**Në parkun e Industrial në Viti parcela të lira:**

Të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të percaktuara me konkurs, që kanë për qëllim zvoglimin e papunisë dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Parcelat janë fleksibile dhe mund të riparcelohen varsisht nga projekti I subjekteve aplikuese e që konsiderohet me rëndësi për Komunën.

Veprimtarit e lejuara në parkun industrial janë të gjitha veprimtarit afariste të cilat nuk cenojnë rendin public, mbrojtjen e shëndetit public, mjedin , folorën dhe faunën dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**Perparsitë** për vendosje në parkun industrial do të kenë ato biznese të cilat Mirren me veprimtari prodhuese, perpunimit të produkteve si dhe inpakti në rritjen e punësimit

**E drejta aplikimit**-Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset e interesuara, vendore apo të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara, si dhe bizneset që ofrojnë shërbime të përbashkëta brenda Zona ekonomike

#### **Informata Promovuese**

Pozitë e pershtatshme gjeografike

Buxhet I qëndrueshëm I qeverisjës locale

Parcelat e thjeshta locale dhe për biznese

Egzistimi I resurseve për energji alternative

Kapacitete të resurseve njerzore, humane dhe pregaditja profesionale e tyre

Staf I knaqëshëm I profileve të ndryshme

Dokumentacioni I nevojshëm për aplikim: me rastin e aplikimit për tu vendosur në parkun industrial duhet ti dorzojnë këto dokumenta:

Formulari i plotësuar së bashku me dokumentacionin tjetër të nevojshëm

Certifikatën e regjistrimit të biznesit

,Historiatin e kompanisë biznesit,

Historiatin e kompanisë që aplikon,

Veprimtarin që do ta zhvillojë në zonen ekonomike

Projektin ideor-pamjën vizuale

Fletëpagesen e cila mirret tek Qendra për shërbim me qytetar.

Bizneset e aprovuara në parim Brenda afatit kohor prej 30 ditëve duhet të sjellin dokumentacionin si në vijim:

Vërtetimin nga administrate tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore

Dëshmi nga ATK për numrin e të punësuarve

Planin e Biznesit

#### **Kriteret e vlersimit:**

Punësimi 40 pikë

Vlera investive 30 pikë

Lloji i veprimtarisë 30 pikë

-Prodhuese 30 pikë

- Përpunuese 20 pikë

-Shërbyese 10 pikë

Afati I dhënjës së pronave në shfrytëzim është nëndhjet e nëntë vite 99 vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

#### **Tërheqja e formularit:**

Formulari për aplikim mund të mirret në zyrën për buxhet dhe financa çdo dite pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00 ose në formën elektronike në faqen e Komunes së Vitisë.

#### **Ku duhet të dorzohet dokumentacioni:**

Formulari i plotësuar së bashku me dokumentacionin dorzohen në mënyrë fizike në qendren për shërbim me qytetar me pliko të mbyllura të vulosura me vulën e biznesit, I cili I adresohet komisionit për vlersimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave për dhënjën e pronës në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës.

**Afati për aplikim: Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të komunës së vitisë.**

**Informatë shtese: bizneset të cilat do të perzgjedhen conform procedurave të dispozitave ligjore në tri 3 vitet e para nga nënshkrimi i kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas 3 viteve do të paguajnë sinë vijim:**

**Vitet e operimit-qmimi m<sup>2</sup> në vit- qmimi në ha në vit**

**Në 3 vitet e para-00 euro                      00 euro**

**Prej vitit të 4 të deri në vitin e 7 në meter katror 00.7 euro në hektar të 700 euro në vit**

**Prej vitit 8 të deri në vitin e 10 të në meter katror 0.11 euro në hektar 1100 euro në vit**

**Prej vitit 11 të, 0.25 euro për meter katror në hektar 1.250.00 euro në vit**

**Aplikuesit në momentin e aplikimit bazuar në Rregulloren për taksat ngarkesa dhe gjyba duhet të paguajnë 100 euro për aplikim dhe duhet një zarf i mbyllur.**

**Vërejtje: Aplikacionet e dorzuara pas mbylljes së afatit të konkursit nuk do të mirren në shqyrtim përveç atyre që arrijnë përmes postës të cilat mbajnë datën e fundit të caktuar në konkurs deri në ora 16:00.**

**E drejta në ankesë bizneseve të cilave ju refuzohet e drejta për të vendosur në parkun industrial kanë të drejtë ankesë komisionit të ankesave Brenda afatit prej 8 ditëve pune.**

